

Neni 21
Këshilli i Administrimit

1. Këshilli i administrimit është organ kolegjal vendimmarrës, që mbikëqyr e kontrollon veprimtaritë e universitetit, që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij.
2. Funkcionet kryesore të këshillit të administrimit janë:
 - a. miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare;
 - b. miraton, me kërkesën e senatit akademik, projektbuxhetin e institucionit me dy të tretat e votave;
 - c. vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të ligjshme dhe publikon rezultatet e vlerësimit;
 - d. miraton strukturën dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet;
 - e. miraton raportin vjetor financiar të paraqitur nga Rektorati;
 - f. vlerëson planin e zhvillimit të institucionit e programin vjetor të veprimtarive të tij;
 - g. miraton rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
 - h. miraton rregulloren e funksionimit të tij;
 - i. informon Senatin Akademik dhe Rektorin për situatën financiare dhe projektet përkatëse për të gjithë Universitetin.
3. Rektori dhe kancelari i institucionit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit të administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky këshill.
4. Këshilli i administrimit përbëhet nga 17 anëtarë:
 - a- përfaqësues të zgjedhur nga UPT (9 anëtarë)
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike;
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave;
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
 - 1 përfaqësues nga Fakulteti i Formimit të Përgjithshëm
 - 1 përfaqësues nga Instituti i Gjeoshkencave;
 - 1 përfaqësues nga Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
 - 1 përfaqësues nga studentët
 - b- 8 anëtarë të emëruar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues nga fushat e shkencës, ekonomisë, kulturës, autoritete të pushtetit qendror dhe vendor;

5. Anëtarët sipas shkronjës “b” të pikës 4 të këtij neni, emërohen dhe shkarkohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Numri i anëtarëve të emëruar është një më pak se gjysma e numrit të anëtarëve të Këshillit të administrimit. Këshilli i administrimit zgjedh kryetarin, prej anëtarëve të brendshëm të tij, me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve.
6. Anëtarësia në Këshillin e Administrimit është e papajtueshme me detyrën e anëtarit të senatit akademik, të zëvendësrektorëve, të dekanëve/drejtorëve dhe të zëvendësdekanëve/zëvendës drejtorëve.
7. Mandati i anëtarit të Këshillit të Administrimit mbaron kur:
 - a. përmbushet afati i mandatit;
 - b. jep dorëheqjen;
 - c. largohet nga UPT, për ata që janë caktuar sipas pikës 4, shkronjat “a” të këtij neni;
 - d. bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrisë funksionin;
 - e. kur nuk merr pjesë, për 3 herë radhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjen e Këshillit të Administrimit;
 - f. për anëtarët që janë emëruar sipas pikës 4, shkronja “b”, të këtij neni, kur lirohen me akt të ministrit.
8. Vendi i mbetur vakant për anëtarët që zgjidhen nga personeli akademik, plotësohet në përputhje me pikën 3.5. të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për periudhën 2007-2011”.
9. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve, rendi i ditës, pjesëmarrja, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to parashikohen në rregulloren e brendshme të Këshillit të Administrimit.